

IZMIT DURMISHI

KONGRESI I MANASTIRIT – NGJARJE MADHORE PËR NJËSIMIN E ALFABETIT TË SHQIPES

811. 18 (091)

Kongresi i Manastirit përbën një nga ngjarjet më të shënuara në historinë e kulturës dhe të kombit shqiptar në tërësi, si dhe një nga arritjet më të mëdha, krahas Kongresit të Drejtshkrimit të vitit 1972, në fushën e kulturës shqiptare në shek. XX.

Me zgjidhjen e çështjes së njësimin të alfabetit të gjuhës shqipe, Kongresi i Manastirit i vitit 1908 mbylli një epokë të tërë në historinë e kulturës shqiptare, kurorëzoi me sukses përpjekjet, që mendjet më të ndritura të kombit shqiptar bënë gjatë shekujve për shkrimin dhe lëvrimin e gjuhës shqipe, për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit grafik të saj, për të përpunuar një alfabet sa më të saktë e të përshtatshëm për gjuhën shqipe dhe të përbashkët për gjithë shqiptarët.

Me të drejtë kishte pohuar gjuhëtari i madh francez Antuan Meje se “ata që e zbuluan alfabetin ishin gjuhëtarët më të mëdhenj”, duke na bërë me dije se shndërrimi i gjuhës në simbolizëm është në detyrë tejet e vështirë. Pra, le të përkujtojmë edhe një herë pohimin se shpikja e alfabetit mund të merret si një ndër zbulimet më të mëdha të njerëzimit.

Shkrimi i shqipes para Kongresit të Manastirit

Për ta pasur më të qartë rrjedhën e shkrimit të shqipes, po rikujtojmë disa momente të historikut të tij.

Shqipja si një nga gjuhët më të vjetra të Gadishullit Ballkanik, ka filluar të shkruhet relativisht vonë. Dëshmitë e shkrimit të saj duken që në pjesën e parë të shekullit XIV (1332) kur murgu frëng Brokard bën fjalë për libra në gjuhën shqipe. Që këtu zë fill shkrimi i shqipes me bazë të alfabetit latin. Sidoqoftë, në krahasim me disa gjuhë të tjera indoeuropiane, shqipja ka nisur të shkruhet vonë. Arsytet e kësaj vonese mund të kuptohen lehtë, po të kemi parasysh se vendi ynë edhe pas ndarjes së Perandorisë Romake ka qenë nën sundimin e gjatë të pushtuesve të huaj (bizantinë, sllavë etj.), të cilët janë përpjekur me të gjitha mjetet për ta asimiluar atë. Lidhur me këtë duhet përmendur edhe roli frenues, që kanë luajtur dy gjuhët e mëdha të kulturës, latinishtja dhe greqishtja, të cilat pas përhapjes së krishtërimit në Shqipëri kanë shërbyer edhe si gjuhë liturgjike, e para kryesisht në Shqipërinë Veriore, ku mbizotëroi katolicizmi, dhe e dyta në Shqipërinë Jugore, ku mbizotëroi ortodoksizmi. Edhe islamizmi, i përhapur në Shqipëri pas pushtimit osman, si gjuhë liturgjike pranonte vetëm arabishten, ndërsa si gjuhë të administratës turqishten.

Autorët e letërsisë së vjetër, si: Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani kanë përdorur një alfabet të mbështetur në *alfabetin latin* dhe të plotësuar me disa shkronja cirilike. Ky alfabet, që e gjejmë të përdorur së pari te Buzuku, në formën e përpunuar nga autorët e mëpastajmë veriorë u bë tradicional në shkrimet fetare katolike dhe ka vazhduar të përdoret në Shkodër deri në vitin 1909, d.m.th. deri pas Kongresit të Manastirit.

Në bazë të veprave të botuara, që njohim deri më sot, del se gjatë shekujve XVI-XVII shqipja u shkrua vetëm nga autorët e Shqipërisë së Veriut (si edhe tek arbëreshët e Italisë). Por përpjekjet për shkrimin e shqipes nuk kanë munguar edhe në Shqipërinë Jugore.

Gjithsesi, gjendja ndryshoi në shekullin e XVIII, kur shkrimi i shqipes u përhap edhe në Shqipërinë e Mesme e Jugore, sidomos në Elbasan, Voskopojë, Berat etj., d.m.th. në ato qendra që patën njëfarë zhvillimi të mirë ekonomik e kulturor. Autorë të ndryshëm shqiptarë, që kanë jetuar gjatë shek. XVIII, na kanë lënë vepra të shkruara me alfabetë të ndryshme, gjë që ishte e pashmangshme në kushtet e sundimit të huaj në Shqipërinë e asaj kohe. Ndërsa Gjon Nikollë Kazazi prej Gjakove botoi në Romë më 1743 një libër të vogël katekizmi me alfabetin tradicional të Veriut me ndonjë ndryshim të vogël, një autor anonim, me origjinë të papërcaktuar, që duhet të ketë jetuar në Elbasan, në të njëjtën kohë përktheu në gjuhën shqipe disa shkrime fetare duke i shkruar me *një alfabet të veçantë prej më se 40 shkronjash*. Pas tij Theodor Haxhifilipi (Dhaskal Todri) prej Elbasani përktheu gjithashtu disa shkrime fetare duke i shkruar ato me një alfabet tjetër të veçantë prej 52 shkronjash. Kurse voskopojarët Theodor Kavaljoti dhe Danil Haxhiu, botuan një libër me karakter shkollor, ku pjesët në gjuhën shqipe i shkruan me alfabet grek.

Në të njëjtën kohë zë fill në qendra të tilla si Berati etj., një letërsi e ndikuar nga kultura turko-orientale. Është fjala për veprat e bejtexhinjve Nezim Frakulla nga Berati, Hasan Zyko Kamberit prej Kolonje etj., të cilët shkruan vargje me alfabet arab në një shqipe të mbushur me fjalë turke, arabe e persiane.

Hovi i lëvrimit të shqipes gjatë Rilindjes Kombëtare

Lëvrimi i gjuhës shqipe mori hov të madh në epokën e Rilindjes. Pikërisht kësaj epoke i takoi të zgjidhte këtë detyrë të madhe, sa historike aq edhe të ngutshme, sikurse ishte çështja e njësimit të alfabetit të gjuhës shqipe. Rilindja shënoi jo vetëm lëvizjen më të fuqishme dhe më të organizuar politike, që shqiptarët kishin njohur deri atëherë, por edhe një zhvillim të gjithanshëm të mendimit politik dhe kulturor kombëtar, të gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Ajo ishte një lëvizje e gjerë shqiptare dhe e gjithanshme kombëtare, me një përmbajtje të re ideologjike, politike-kulturore, ekonomike-shoqërore dhe organizative, që synonte të çlironte vendin nga sundimtarët e huaj osmanë, të bashkonte trojet shqiptare në një shtet të vetëm e të pavarur, t'u hapte rrugën zhvillimit e përparimit ekonomik-shoqëror e kulturor të Shqipërisë. Jo më kot pohonte akademik Rexhep Qosja se, synimi i parë dhe i fundit i rilindasve ka qenë të bëhej Shqipëria dhe shqiptarët.

Rilindja solli përparime të mëdha në kulturën e shqiptarëve e në radhë të parë në lëvrimin e gjuhës shqipe, e cila ishte tipari themelor i kombit shqiptar, nyja qendrore që bashkonte gjithë shqiptarët, pa dallim krahine e feje. Gjatë Rilindjes u hodhën themelet e gjuhës letrare shqipe, të letërsisë dhe të kulturës së sotme shqiptare në tërësi.

Në këtë periudhë të errët të sundimit të Perandorisë Osmane mohohej ekzistenca e kombësisë shqiptare, nuk u njihej shqiptarëve identiteti kombëtar. Me konceptin e tyre mesjetar të “miletit”, sulltanët osmanë vinin shenjën e barazimit midis fesë dhe kombësisë, e përdornin ndarjen e shqiptarëve në tri besime për t'u mohuar atyre kombësinë duke i quajtur shqiptarët myslimanë “turq”, ata ortodoksë “rumë” (grekë) dhe katolikët “latinë”. Nën ndikimin e klerit ishte vënë edhe arsimi në Shqipëri, që përgjithësisht jepej në gjuhë të huaj (turqisht, greqisht, italisht). Shqiptarëve u ndalohej me çdo mjet mësimi dhe shkrimi i gjuhës amtare shqipe, nuk lejohej, siç shprehej Sami Frashëri, në vitin 1899 “*të shkruhej asnjë copë kartë në gjuhën tënë*” dhe “ndalohej të hapurit e shkollave shqipe”. Rilindasit arritën në përfundimin e drejtë se për ta bërë gjuhën shqipe një mjet bashkimi, ishte e nevojshme që ajo të shkruhej e të këndohej me një alfabet të vetëm. “Një gjuhë që s’shkruhet e s’këndohet, -shkruante Samiu, - nuk zihet gjuhë”.

Në kushte të tilla dolën nga gjiri i popullit shqiptar një varg atdhetarësh të ndritur, të cilët, të shtytur nga dashuria për atdhenë, iu përveshën punës me vetëmohim për t'i ndriçuar popullit tonë rrugën drejt lirisë. Midis tyre vend të shquar zënë shkrimtarët atdhetarë Naum Veqilharxhi, Konstandin Kristoforidhi, vëllezërit Naim e Sami Frashëri, Jani Vreto, Vaso Pasha etj. Të përmendurit i dhanë një rëndësi të madhe përhapjes së arsimit e të diturisë në gjuhën amtare.

Çështja e alfabetit në fund të shek.XIX dhe fillim të shek.XX

Fillimi i hapjes së shkollave shqipe nga njëra anë, dhe librat e të përkohshmet e botuara nga kolonitë shqiptare të Bukureshtit dhe Sofjes, nga ana tjetër, ndihmuan jo vetëm për zgjimin dhe forcimin e ndërgjegjes kombëtare, por edhe për përhapjen e alfabetit të Stambollit, i cili me kohë nisi të konsiderohej nga shumë shqiptarë si një alfabet kombëtar. Ende çështja e një alfabeti të përbashkët ishte një gordiane për shqiptarët. Alfabeti i Stambollit u përhap vetëm në Shqipërinë Jugore e të Mesme si edhe në disa koloni shqiptare të mërgimit, si në ato të Stambollit, Bukureshtit, Sofjes etj. Përkundrazi, në Shqipërinë e Veriut, me kryeqendër Shkodrën, ky alfabet nuk u përhap. Kështu pas vitit 1899 çështja e alfabetit u ndërlikua edhe më keq. Në këtë vit u themelua në Shkodër shoqëria “Bashkimi” e françeskanëve, e cila sajoi në alfabet të ri, të mbështetur në alfabetin latin dhe të plotësuar me disa dyshkronjësja. E pas vitit 1901 numri i alfabeleve, që përdorehin në Shkodër, u shtua, sepse edhe shoqëria e jezuitëve “Agimi” sajoi një alfabet të vetin, të mbështetur gjithashtu në alfabetin latin, por të plotësuar me disa shkronja latine me shenja diakritike. Kështu, në një qytet të vetëm si Shkodra, ku ndesheshin edhe intereset e Austro-Hungarisë e të Italisë midis vjetëve 1901-1908 për shkrimin e shqipes përdorehin të paktën 3 alfabete të ndryshme.

Përveç këtyre alfabeleve dhe alfabetit të Stambollit, para vitit 1908 janë përdorur edhe alfabete të tjera të mbështetura kryesisht në alfabetin latin. P.sh. e përkohshmja “Shqipëria e Bukureshtit” (1897-1898), “Albania” e Faik Konicës (Bruksel-Londër, 1897-1909), “Kombi” i Bostonit (1906-1909), “Besa” (1904), “Shqipëria” (1906), “Pellazgu” (1907) të Kajros etj., botoheshin vërtet me alfabet latin, por me ndryshime midis tyre.

Një kontribut të veçantë në lëvrimin e shkrimit dhe të gjuhës letrare dha revista “Albania” (Bruksel-Londër, 1897-1909) dhe editorit i saj Faik Konica. Në këtë organ sipas vlerësimit të Tomor Osmanit, u botuan në vitet e fundit të shek. XIX e në fillim të shek. XX më shumë se 20 artikuj, diskutime e letra për çështjes e njësisimit të alfabetit, disa të shkruara pikërisht nga “ustai (mjeshtri) më i madh i shkrimit të shqipes” - Faik Konica, siç do të quante Noli.

Edhe mendjet e ndritura të asaj kohe si, A.Z.Çajupi, Hilë Mosi, A.S.Drenova, Mithat Frashëri, Shahin Kolonja, Aleksandër Xhuvani, Fan Noli, Ndre Mjeda, Loni Logori, Sotir Peci etj., në artikujt e botuar të asaj kohe (1897-1908) në gazetatat e revistat shqipe kritikuan përdorimin e alfabeleve të ndryshme nga shoqëritë kulturore dhe nga organet e shtypit.

Çështja e alfabetit dhe vendimet e Kongresit të Manastirit

Në një situatë të tillë të parapërgatitur nga lëvruesit e denjë të shqipes brenda dhe jashtë vendit, dhe falë punës së madhe përgatitore dhe organizative, që zhvilloi klubi i Manastirit dhe klubet dhe shoqëritë e tjera shqiptare, më 14 nëntor të vitit 1908 u mbledh në Manastir, në ndërtesën ku ishte vendosur selia e klubit “Bashkimi”, Kongresi për njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe, që i vazhdoi punimet e tij *deri më 22 nëntor*. Në Kongres morën pjesë 32 delegatë me të dretë vote, që përfaqësonin 26 qytete dhe shoqëri të ndryshme shqiptare brenda dhe jashtë vendit. Meqë çdo klub ose shoqëri kishte të drejtë të dërgonte në Kongres 2 delegatë, 32 delegatët kishin 52 vota (disa prej tyre kishin nga dy vota). Përveç këtyre në

Kongres morën pjesë edhe 18 delegatë të tjerë si pjesëmarrës pa të drejtë vote. Në këtë mënyrë Kongresi i Manastirit u shndërrua në një kuvend mbarëshqiptar, ku morën pjesë gjithsej 50 delegatë nga të gjitha anët e Shqipërisë, nga qytetet e vilajeteve të Shkodrës, të Kosovës, të Manastirit dhe të Janinës, si dhe nga shoqëritë shqiptare të Sofjes, të Bukureshtit, të Kostancës, të Amerikës, të Egjiptit, të Italisë etj.

Tridhjetë delegatët me të drejtë vote ishin shkrimtarë e publicistë të njohur, lëvrues të gjuhës shqipe, laikë e klerikë, veprimtarë të lëvizjes kombëtare dhe të klubeve shqiptare si: Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, Sotir Peci, Mithat Frashëri, Shahin Kolonja, Dhimitër Buda, Ndre Mjeda, Gjergj Qiriazi, Bajo Topulli, Nyzhet Vrioni, Grigor Cilka, Nikollë Kaçori, Fehim Zavalani, Dhimitër Mole, Rrok Berisha, Thoma Avrami, Hilë Mosi, Akil Eftimiu, Adham Shkaba, Mati Logoreci, Azis Beu (Shkodër), Shefqet Frashëri, Simon Shuteriqi, Leonidha Naço, Zejnel Glina, Sami Pojani, Refik Toptani, Mihal Grameno, Hafiz Ibrahim efendiu (Shkup), Emin Haxhiu (Shkup), Rauf Beu (Gjirokastrë), Salahedin Beu (Manastir).

Seancën e hapjes së punimeve të Kongresit e drejtuan, si kryetarë të saj Rexhep Hoxha (Efendiu) dhe Fehim Zavalani, kryetar i klubit “Bashkimi” të Manastirit. Mbledhjet e ditës së parë dhe të dytë u zhvilluan të hapura, në to morën pjesë rreth 400 veta. Gjatë dy ditëve të para pati shumë diskutime për të përcaktuar parimet e hartimit të alfabetit dhe zgjedhjen e shkronjave. Në ditën e tretë, pasdreke, me vota të fshehta u zgjodh Komisioni fuqiplotë i alfabetit prej 11 anëtarësh: Gjergj Fishta, Mithat Frashëri, Luigj Gurakuqi, Gjergj Qiriazi, Ndre Mjeda, Grigor Cilka, Dhimitri Buda, Shahin Kolonja, Sotir Peci, Bajo Topulli dhe Nyzhet Bej Vrioni. Në punën e tyre të mundimshme triditëshe, por të frytshme u shqyrtuan tri mundësi: a) të përshtatej njëri nga tri alfabetet më të përhapura në atë kohë: *alfabeti i Stambollit, i shoqërisë “Bashkimi”* ose *i shoqërisë “Agimi”*; b) të bëhej kombinimi i këtyre tri alfabeleve, dhe c) të hartohej një alfabet i ri, duke lënë mënjane alfabetet ekzistuese.

Pas shumë diskutimesh, u zgjodh variant i tretë: *të përpilohej një alfabet i ri për shqipen*. Parimisht u pranua nga të gjithë se alfabeti i shqipes duhet të mbështetej në alfabetin latin. Zgjedhja e alfabetit latin për shkrimin e shqipes ishte edhe një element i emancipimit kulturor të shqiptarëve. Në Kongresin e parë për kodifikimin e alfabetit u përcaktua që shqipja të ketë shkrimin më të përsosur, më të përhapur, më të lehtë e më praktik; pra shkrimin fonetiko- fonologjik. Në këtë lloj shkrimi çdo fonemë jepet me një shkronjë të veçantë, kështu që numri i shenjave është i vogël.

Përfundim

Lënia e mundësisë së përdorimit të dy alfabeleve për shkrimin e shqipes nga Kongresi i Manastirit (i atij latin dhe alfabetit të Stambollit) ishte vendim i matur e largpamës sepse mbylli shtegun e përçarjeve bredashqiptare. Kongresi i Manastirit pati rëndësi të madhe jo vetëm për alfabetin dhe për gjuhën letrare kombëtare, për arsimin e për kulturën në veçanti, por edhe për çështjen kombëtare shqiptare në përgjithësi. Vendimet e Kongresit, që ishin kurorëzim i veprimtarisë së shumë brezave lëvruesish të shqipes dhe i përpjekjeve të pandërprera për afrimin dhe njësimin e gjuhës shqipe e të kombit shqiptar, u pritën me gëzim dhe u vunë menjëherë në zbatim. Brenda pak vitesh alfabeti latin i krijuar nga Kongresi, që është alfabeti ynë i sotëm, u përhap shpejt dhe u bë alfabeti i vetëm i shqipes. Ai është kurorëzim i përpjekjeve disashekullore të mendjeve më të ndritura të kombit. Alfabeti i përbashkët dhe i ndërtuar drejt hapi rrugën për një emancipim kulturor, për një drejtshkrim të përbashkët dhe për një gjuhë standarde të përbashkët për të gjithë shqiptarët, siç e kemi sot.

Literatura:

1. Justin Rrota, *Për historinë e alfabetit shqip*, Shkodër, 1936.
2. Tomor Osmani, *Historia e alfabetit të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1987.

3. Emil Lafe, *Alfabeti i Kongresit të Manastirit i vështruar nga koha e sotme*, “Studime filologjike”, Tiranë, 1999/1-2.
4. Asllan Hamiti, *Alfabeti i gjuhës shqipe*, Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe, Shkup, 2005.
5. Shezai Rrokaj, *Drejt Kongresit të Manastirit me idenë një alfabet, një gjuhë një komb*, Çështje të Gjuhës Shqipe 2, Tiranë, 2009.
6. Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe I-II*, Rilindja, Prishtinë, 1984.
7. Rexhep Qosja, *Ligjërime paravajtëse*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1996.
8. Avzi Mustafa, *Studime dhe artikuj*, UISHM, Shkup, 2012.